



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

## RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË MBROJTJES PËR VITIN 2022

Raporti i nënshkruar nga

Vlora Spanca,

Auditore e Përgjithshme

**Prishtinë, qershor 2023**

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Mbrojtjes (MM), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Mbrojtjes, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

A1 Ministria e Mbrojtjes në vitin 2022 kishte mbyllur avansin në vlerë 1,377,179€, pa i pranuar shërbimet e trajnimit.

*Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për

Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Mbrojtjes kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

### **Baza për konkluzion**

A2 Te furnizimi me automjete transporti me kombi-bus në vlerë prej 1,448,911€, ishte zhvilluar procedura e negociuar pa publikim dhe kishte vonesa në liferimin e mallit.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

### **Çështje tjetër**

1 Kontratat dhe pagesat në kategoritë, investime kapitale dhe mallra shërbime të cilat ishin të klasifikuara (niveli i kufizuar) nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, nuk janë pjesë e këtij raporti. Këto kontrata dhe pagesa auditohen ndaras dhe përgatitet një raport i veçantë i auditimit i cili do të ju komunikohet vetëm palëve përgjegjëse. Përderisa lëndët që e kanë nivelin e klasifikimit Sekret nuk janë audituar.

### **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Mbrojtjes është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Mbrojtjes.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Ministrisë së Mbrojtjes është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve

financiare të Ministrisë së Mbrojtjes në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Mbrojtjes me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Mbrojtjes.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave

financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Ministria ka shpenzuar rreth 95% të buxhetit final ose 137,592,675€ me një përqindje të njëjtë të realizimit si në vitin 2021. Fushat me probleme të theksuara kanë të bëjnë me menaxhimin e proceseve të prokurimit si: specifikime jo të qarta, aplikimi i procedurave kufizues dhe vonesa në realizimin e projekteve. Mangësi tjera në menaxhimin e financave ishin edhe mbyllja e avansit pa ofrim të shërbimeve, vonesa në pagesën e faturave dhe prezantimi jo i drejtë i detyrimeve kontingjente dhe pasurive (stoqeve).

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime prej tyre gjashtë (6) janë rekomandime të reja dhe një (1) pjesërishtë i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

### Çështja A1 - Mbyllja e avansit pa pranim të plotë të shërbimeve të trajnimit

**Gjetja** Rregullorja nr.01/2013 për Shpenzimin e parave publike përcakton procedurat/hapat që duhet të përmbushen për njohjen dhe regjistrimin e një shpenzimi.

Në prill të 2022, Ministria kishte dhënë avans në vlerën prej 1,390,459€, për trajnimin e pjesëtarëve të FSK-së bazuar në Marrëveshjen me Foreign Military Sales (FMS). Trajnimet ishin paraparë të mbahen nga 03 tetori deri më 30 nëntor 2022, megjithatë deri në fund të vitit 2022 ishin mbajtur vetëm dy trajnime në vlerë 13,280€, përderisa pjesa tjetër e trajnimeve në vlerë 1,377,179€ ishin shtyrë për vitet në vijim. Me vendim të menaxhmentit në fund vit ishte bërë mbyllja e plotë e avansit, njohja dhe regjistrimi i shpenzimit, përkundër që shërbimet e trajnimit ishin pranuar në vlerë shumë të ulët.

Fakti që marrëveshja ishte me FMS dhe siguria e ofrimit të shërbimeve konsiderohej e lartë, MM nuk kishte paraparë se ekziston ndonjë rrezik në lidhje me mos ofrimin e këtyre shërbimeve/trajnimeve. Mbyllja e avansit ishte bërë me qëllim që mos të bartet si obligim në vitin e ardhshëm duke atakuar buxhetin e vitit pasues, pasi që trajnimi ishte shtyrë për vitet në vijim.

**Ndikimi** Kjo mënyrë e mbylljes së avansit pa u ofruar trajnimi nuk është në përputhje me rregullat financiare dhe rritë rrezikun që mos të ofrohen shërbimet e trajnimi dhe rrjedhimisht të mos arrihen objektivat

**Rekomandimi A1** Ministri duhet të siguroj se janë vendosur kontrole efektive me qëllim që të parandalohet mbyllja e avanseve para se të jenë pranuar shërbimet e trajnimit sipas marrëveshjes. Po ashtu, duhet të sigurohet një monitorim efektiv rreth pranimit të trajnimeve për të cilat ishte dhënë avansi.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A2 - Aplikimi i procedurës negociuar pa publikim dhe vonesë në liferimin e mallit

#### Gjetja

Neni 32 i LPP-së nr.04/L-042 thekson se gjatë ushtrimit të një aktiviteti të prokurimit AK duhet të shfrytëzojë procedurën e hapur ose procedurën e kufizuar. Procedura e negociuar pa publikim mund të përdoret kur për arsye objektive, teknike ose artistike kontrata duhet ti ipet një operatori të caktuar, nëse për arsye intelektuale-autoriale dhe për arsye të emergjencave ekstreme. Ne vërejtëm se:

Për tenderin "Furnizim me automjete transporti, Kombi-bus" për nevoja të FSK-së ishte zhvilluar procedurë e hapur e prokurimit. Në dosjen e tenderit te specifikat teknike ishte kërkuar që Kombi-busi të ketë minimumi 22 ulëse dhe afati i liferimit të jetë para fundit të vitit fiskal (afati 15 dhjetor 2022). Asnjë ofertë e përgjegjshme nuk ishte pranuar me këto kritere.

Pas kësaj, Ministria ka emëruar një komision për hulumtimin e tregut, i cili kishte ardhur në përfundim se duhet ndryshuar specifikimet teknike dhe Kombi-busi të jetë versioni 19+1.

Ministria kishte ri-shpallur tenderin për të njëjtin furnizim duke e aplikuar procedurën e negociuar pa publikim, për aplikimin e kësaj procedure kishte njoftuar paraprakisht Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik. Nga procesi vërehet se ndryshimi i procedurës nga e hapur te e negociuar ka ardhur duke i ndryshuar specifikat teknike (numri i ulëseve), e që zgjon dilemën nëse me këto specifika të reja kishte konkurrencë dhe mund të aplikohet përsëri procedura e hapur. Aplikimi i procedurës së negociuar nuk ishte justifikuar pasi që asnjëra nga kriteret nuk ishte përmbushur.

Kontrata ishte nënshkruar me vlerë prej 1,448,911€. Sipas kontratës Kombi-busi duhet të jetë versioni 19+1 kurse afati i liferimit para fundit të vitit fiskal 2022.

Deri në fund të vitit 2022 asnjë Kombi-bus nuk ishte pranuar, përderisa deri në fillim të muajit prill 2023 janë pranuar vetëm 7 nga 18 kombi-busët e kontraktuar.

Përcaktim i afatit për furnizim nga ana e Ministrisë dhe mos hulumtimi i tregut në fazat e hershme të planifikimit kanë qenë shkaktari i mangësive në fazat e mëvonshme të procesit të prokurimit.

#### Ndikimi

Shmangia e procedurave të hapura të prokurimit eliminon transparencën dhe ndikon në kufizimin e konkurrencës. Kurse vonesat në liferimin e Kombi-Busëve ndikojnë në mos arritjen e synimeve të Ministrisë në përmbushjen e objektivave e po ashtu kanë ndikim edhe në vlerën për parane e shpenzuar.

**Rekomandimi A2** Ministri duhet të siguroj përmes menaxherit të prokurimit dhe njërive kërkuese që para inicimit të aktiviteteve të prokurimit të bëhet hulumtimi i tregut dhe të bëhet planifikimi adekuat i secilit aktivitet të prokurimit. Aplikimi i procedurës së negociuar pa publikim, përdoret për dhënien e çdo lloji të kontratës, nëse rrethanat e arsyetojnë përdorimin e kësaj procedure duke qenë sa më transparent dhe duke eliminuar kufizimin e konkurrencës. Po ashtu, duhet siguruar se aplikohen penalet për shkak të vonesave të theksuara në liferimin e mallit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 16,348,896€, prej tyre ishin shpenzuar 13,788,259€ apo 84%. Ato kanë të bëjnë kryesisht me karburant për vetura, furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare), shërbimet e arsimit dhe trajnimit etj.

#### **Çështja A3 - Vonesë në realizimin e Projektit “Digjitalizimi i kuzhinës”**

**Gjetja** Projekti “Furnizim me pajisje për digjitalizimin e sistemit të shërbimit me ushqim në kuzhina, për nevojat e FSK-së” në vlerë prej 49,275€, është duke u vonuar në realizim për së paku 5 muaj (realizimi i projektit nuk është kryer deri në mars 2023 koha kur ne ishim në auditimit dhe ende vazhdon).

Projekti ishte paraparë të realizohej brenda 2 muajve sipas nenit 2 të kontratës i cili thekson se “afati kohor për dorëzim të pajisjeve do të jetë 60 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes (data e lëshimit të urdhër blerjes ishte me 26.08.2022) nga ana e Autoritetit Kontraktues”.

Vonesa ka ndodhur për shkak, se Forca e Sigurisë së Kosovë (FSK) nuk kishte përgatitur infrastrukturën e rrjetit të internetit dhe vendosjen e furnizimit me energji elektrike për tabletët në mënyrë që të bëhet instalimi i softuerit dhe testimi i funksionimit të sistemit të digjitalizimit në kuzhina.

**Ndikimi** Mos përgatitja e kushteve infrastrukturore me kohë nga ana e FSK-së tregon se projekti kishte dobësi në planifikim. Vonesat e theksuara në realizim reflektojnë në mos arritjen e objektivave të parapara me buxhetin e vitit aktual, e që problemet e tilla mund të sjellin edhe vështirësi financiare për vitin e ardhshëm fiskal, duke kufizuar realizimin e projekteve të reja.

**Rekomandimi A3** Ministri në koordinim me FSK-në duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet konkrete dhe me kohë për krijimin e parakushteve të infrastrukturës për të mundësuar përmbushjen e secilës kontratë të nënshkruar sipas kushteve të parapara.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 97,944,277€, prej tyre ishin shpenzuar 93,899,796€ apo 96%. Ato kanë të bëjnë me avance për investime, pajisje ushtarake, automjete transporti, ndërtesa, pajisje të teknologjisë Informative dhe pajisje tjera.

### Çështja A4 - Specifikimi jo i qartë i kërkesave në dosje të tenderit

#### Gjetja

Neni 59 i Ligjit të Prokurimit Publik nr.04/L-042, thekson se Autoriteti kontraktues (AK) do të konsideroj një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Në dy dosje të tenderit kemi identifikuar se të Kërkesat minimale kualifikuese përkatësisht kërkesat mbi kapacitetet teknike dhe profesionale nuk janë të specifikuara qartë edhe si kërkesa e edhe si dëshmi përmbushjen e tyre si:

- Në dosjen e tenderit për projektin “Ndërtimi i depove për logjistikë në Kazermën e Ferizajt” vërejtëm se ishte kërkuar që OE të kishte minimum 25 punëtor por nuk ishte e qartë që përveç stafit profesional a kërkohej edhe për punëtorët tjerë kopje të diplomave certifikatave, CV-it, kopjet e kontratave të punës ose para kontrata me emër të projektit; dhe
- Në dosjen e tenderit “Furnizim me pjesë ndërrimi dhe shërbime mirëmbajtje për automjete” - Lloti 3, kërkohej që OE të posedonte: listën e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike, në origjinal të nënshkruar dhe vulosur (nuk ishte e definuar se cilat mjete kërkohej). OE fitues nuk e posedonte listën në fjalë, por vetëm foto të pajisjeve pa dokumentim përkatës.

Këto lloje të paqartësive janë dukuri dhe vërehen edhe te shumë dosje tjera të tenderëve. Kjo ka ndodhur si rezultat i moskujdesit gjatë hartimit të kriterëve në dosje të tenderit dhe nga neglizhenca e komisioneve të cilët kanë anashkaluar kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit, duke mos vlerësuar drejt kriteret tek kapacitetet teknike dhe profesionale.

#### Ndikimi

Mos definimi i qartë i kriterëve dhe dëshmimeve përkatëse në lidhje me kapacitetet teknike dhe profesionale ndikon në konfuzion të OE dhe e vështirëson edhe procesin e vlerësimit të ofertave nga ana e komisionit. Po ashtu kjo mund të ndikoj që pa u përmbushur kriteret e kërkuara të mund të përzgjedhen ofertat dhe më pas ofertuesit e shpërblyer me kontratë të mos jenë në gjendje të përmbushin kontratën me kohë dhe cilësinë e kërkuar.

**Rekomandimi A4** Ministri përmes menaxherit të prokurimit dhe njësive kërkuese duhet të siguroj se kriteret në dosje të tenderit të jenë specifike, të qarta, të matshme dhe dëshmitë e kërkuara të jenë të ndërlidhura me ato kritere.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 180,607,644€, pasurive jokapitale është 3,403,452€, si dhe e stoqeve 10,089,415€.

#### Çështja C1 - Mangësi në regjistrimin e pasurisë

##### Gjetja

Sipas Rregullores Financiare MF nr. 02/2013 - Për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në nenin 3 përcaktohet që Regjistri i Përgjithshëm i Pasurive - është një listë e plotë dhe e saktë e të gjitha pasurive jo financiare të zotëruara nga organizatat buxhetore, që nënkupton regjistrin e pasurive kapitale, pasurive jo kapitale dhe stoqeve që azhurnohen rregullisht, dhe që, përveç përdorimit për menaxhim të pasurive, do të përdoret edhe për të mbështetur të dhënat e raportuara në pasqyrat financiare. Kurse neni 7 i të njëjtës rregullore Dokumentimi i lëvizjes së pasurisë jo financiare pika 1 përcakton se: Të gjitha lëvizjet e pasurive jo financiare (pranimi, shitja, dhurimi, transferimi dhe asgjësimi) të cilat rezultojnë në ndryshimin e përgjegjësisë menaxheriale dhe përdorimit duhet të mbështeten në dokumente përkatëse. Ne identifikua se:

- Pasuritë e regjistruara në sistemin e-pasuria ishin të mbivlerësuara për 1,987€. Pajisjet individuale taktike, Gas mask (NBC and tactical respirator) në vlerë prej 87,584€ ishin regjistruar në stok 87,320€ dhe Gas mask filter (CBRN) në vlerë 18,536€ janë regjistruar 20,787€. Kjo kishte ndodhur për shkak se furnizimet e reja me artikujt të njëjtë por me çmim të ndryshëm ishin regjistruar me çmimin e fillestar; dhe
- Për pajisjet speciale mjekësore në vlerë neto prej 13,227€ (vlera fillestare 24,800€), MM nuk kishte ndonjë dokument përkatës të pranimit. Këto pasuri ishin transferuar nga SHSKUK në vitin 2021.

Kurse donacioni i pranuar nga SHSKUK zyrtari i pasurisë nuk ishte njoftuar për këtë dhe nuk posedonte ndonjë dëshmi.

##### Ndikimi

Regjistrimi jo i duhur ndikon në raportimin jo të drejtë të vlerës së pasurive. Si rrjedhojë e këtyre mangësive kemi nënvlerësim të pasurive duke rezultuar edhe në prezantimin jo të drejtë të vlerës së tyre në pasqyra financiare. Po ashtu secila pasuri duhet të bazohet në dokumentet burimore origjinale që dëshmojnë se transaksioni ka ndodhur në përputhje me autorizimet përkatëse.

##### Rekomandimi C1

Ministri duhet të siguroj përmes zyrtarit të e-pasurisë korigjimin e gabimeve në mënyrë që pasuritë të janë prezantuar drejtë në PFV. Po ashtu çdo pasuri e fituar-transferuar nga OB tjera të ketë dokumente burimore.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.4 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2022, ishte 4,637,634€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2023.

#### Çështja A5 - Vonesa në pagesën e faturave dhe kostot e përbarimit

##### Gjetja

Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për MFPP, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuar dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Ne identifikuam se:

- Fatura e pranuar në vitin 2020 në vlerë prej 5,169€ nuk ishte paguar në afatin e paraparë ligjor. Pas ankesës së OE dhe vendimit përbarimor, Thesari në mars 2022 kishte ekzekutuar pagesën në vlerë prej 6,478€ nga buxheti i Ministrisë. Nga kjo pagesë 5,169€ ishte borxhi kryesor kurse 1,309€ ishin shpenzimet shtesë në emër të procedurës kontestimore/ përbarimore; dhe
- Fatura e pranuar në mars 2021 në vlerë 4,686€, nuk ishte paguar, për shkak se kjo faturë ishte më e lartë për 64€ në raport me marrëveshjen. Por pranimi i faturës nga ministria mund të jetë subjekt i procedurës përbarimore duke shkaktuar kosto shtesë.

Vonesa në pagesën e faturës ishte për shkak se menaxheri i kontratës pas përfundimit të kontratës nuk i kishte ndërmarr veprimet e nevojshme me kohë, për pagesën e këtij obligimi. Përderisa në rastin e dytë mos pagesa ishte e drejtë nga ana e MM-së por pranimi i faturës duhet të shikoj mundësinë e uljes së rrezikut dhe të paguaj vetëm pjesën që e konsideron si borxh.

##### Ndikimi

Vonesat në realizimin e pagesave në afatin e përcaktuar kanë ndikuar që Ministria të jetë subjekt i padisë nga operatori ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë përbarimore. Po ashtu, edhe pranimi i faturës mund të jetë subjekt i procesit përbarimesh edhe kur OB ka një arsye valide për mos pagesën e faturës.

##### Rekomandimi A5

Ministri duhet të sigurojë se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit ligjor dhe se menaxheret e kontratave duhet ta kenë parasysh afatin e kontratave, në mënyrë që të shmangen kostot shtesë si pasojë e pagesave me procedura përbarimore apo gjyqësore. Po ashtu, duhet shtuar kujdesin gjatë pranimit të faturave për të shmangur devijimet e mundshme në mes faturës dhe marrëveshjes.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.5 Detyrimet kontingjente

Pasqyra e detyrimeve kontingjente në fund të vitit 2022, ishte 309,978€.

#### Çështja A6 - Prezantim jo i saktë i detyrimit kontingjent

##### Gjetja

Rregullorja MF nr.01/2017, Neni 18 obligon Organizatat buxhetore të raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente në PVF. Detyrim kontingjent (Neni 3 pika 1.1)-është një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmen.

Në Raportin Financiar ishin shpalosur detyrimet kontingjente në vlerë prej 309,978€ (prej tyre 189,259€ për MM dhe 120,719€ për ish-TMK).

Lënda ISARS që ka të bëj me padinë për ndërtimin e kuzhinës për ish TMK-në nuk ishte e paraqitur sipas vlerësimit të ekspertizës së fundit në vlerë 125,350€ nga Departamenti për çështje Ekonomike bazuar në aktvendimin e datës 13.02.2019. Kjo lëndë në PFV është shpalosur në vlerë prej 104,992€ duke nënvlerësuar totalin e detyrimeve për 20,358€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos përditësimit të listës së detyrimeve kontingjente nga zyrtarët përgjegjës.

##### Ndikimi

Prezantimi jo i saktë ka ndikuar në nënvlerësim të detyrimit dhe paraqet gjendjen jo reale në Pasqyra Vjetore Financiare.

##### Rekomandimi A6

Ministri duhet të siguroj një koordinim në mes zyrës ligjore dhe ZKF në mënyrë që detyrimet kontingjente azhurnohen dhe prezantohen në përputhje me kërkesat të rregullores për Raportim Vjetor Financiar.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>e</sup>	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>102,305,450</b>	<b>145,218,736</b>	<b>137,592,675</b>	<b>91,615,107</b>	<b>59,485,247</b>
Grante Qeveritare – Buxheti	102,305,450	145,218,726	137,592,665	91,267,418	57,687,676
Te hyrat nga AKP-ja	0	0	0	0	1,297,581
Donacionet e jashtme	0	10	10	347,689	499,990

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 42,913,286€. Ndryshimet buxhetore kanë ardhur si rezultat i rishikimit buxhetor, vendimeve të qeverisë dhe bartjes së donacionit.

Në vitin 2022 Ministria ka shpenzuar afër 95% të buxhetit final ose 137,592,675€ me një përqindje të njëjtë të realizimit si në vitin 2021. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>102,305,450</b>	<b>145,218,736</b>	<b>137,592,675</b>	<b>91,615,107</b>	<b>59,485,247</b>
Pagat dhe mëditjet	31,895,564	29,895,564	29,121,779	25,930,519	25,731,853
Mallrat dhe shërbimet	13,983,886	16,348,896	13,788,259	8,196,552	8,508,797
Komunalitë	1,130,000	1,030,000	782,841	758,968	700,862
Investimet Kapitale	55,296,000	97,944,277	93,899,796	56,729,068	24,543,735

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 2,000,000€, me vendim të Qeverisë. Realizimi i buxhetit final ishte 97%. Zvogëlimi i buxhetit ishte si rezultat i pamundësisë së realizimit të plotë të rekrutimeve të planifikuara. Megjithatë, krahasuar me vitin paraprak kemi rritje të shpenzimeve të kategorisë paga dhe mëditje për 3,191,260€ si rezultat i rekrutimit të rreth 819 kadetëve të rinj në FSK;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,365,010€. Rritje e buxhetit në mallra dhe shërbime vjen nga transferimi ndërmjet kategorive ekonomike 2,330,000€, dhe rritja e buxhetit me vendim të Qeverisë në vlerë 35,010€. Realizimi i buxhetit final ishte 84%; Krahasuar me vitin paraprak kemi rritje të shpenzimeve në këtë kategori për 5,591,707€ e që rritja e shpenzimeve është e ndërlidhur me rritjen e numrit të kadetëve rrjedhimisht furnizimi me uniforma, paisje të nevojshme, ushqim transport etj. Po ashtu, në këtë rritje ka ndikuar që blerja e municionit këtë vit ishte paguar nga kjo kategori;
- Buxheti final për komunalitet krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 100,000€ nga transferimi ndërmjet kategorive ekonomike. Realizimi i buxhetit final ishte 76%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 42,648,277€ me vendime të Qeverisë. Realizimi ishte 96%. Krahasuar me vitin paraprak kemi rritje të shpenzimeve nga kjo kategori për 37,170,728€ e që kjo vjen kryesisht nga blerjet e pajisjeve ushtarake.

Në vitin 2022, nuk ka pasur shpenzime për menaxhimin e emergjencave nga Covid 19.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Ministria në vitin 2022, nuk ka realizuar të hyra, pasi që nuk ka pasur ndonjë aktivitet por që kishte kthime të buxhetit në vlerë 165,919€ dhe këto janë regjistruar si të hyra të vitit të kaluar. Arsyeja e kthimit të këtij buxheti ishte rezultat i ndërprerjes të shkollimit të disa kadetëve.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>47,551</b>	<b>47,551</b>	<b>165,919</b>	<b>6,175</b>	<b>114,488</b>
Të hyrat jo tatimore	47,551	47,551			114,488
Të hyrat tjera	0	0	165,919	6,175	

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 ka rezultuar në shtatë rekomandime. MM kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Gjithashtu, ka dorëzuar Raportin e progresit mbi zbatimin e rekomandimeve me 30 shtator dhe 15 mars.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, ne kemi identifikuar progres pasi që gjashtë (6) rekomandime ishin zbatuar përderisa një (1) ishte pjesërisht i zbatuar siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

### Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak



**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV. Po ashtu, duhet të rishikohen edhe refleksionet që këto keqklasifikime kanë pasur te pasuria dhe të ndërmerren veprime për korigjimin e tyre.	Për vitin 2022 nuk kemi identifikuar mangësi të tilla.	I zbatuar
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj përmes menaxherit të financave që pasuritë janë prezantuar drejtë në PFV. Duhet shtuar kujdesi gjatë procesit të regjistrimit të pasurive dhe gabimet e evidentuara në regjistrin e pasurive duhet të korrigjohen në mënyrë që vlera e prezantuar e pasurive të jetë reale.	Janë bërë korigjimet e nevojshme, mirëpo prap kemi identifikuar probleme tjera në sistemin e-pasuria.	Pjesërisht i zbatuar
3.	Baza për konkluzion	Ministri në bashkëpunim me personat përgjegjës të Njësive të SHPFK, duhet të sigurojë që pranimet e furnizimeve me derivate për ngrohje dhe gjenerator të cilat janë në sasi të konsiderueshme të bëhen nga komisionet prej së paku tre anëtarëve.	Për vitin 2022 nuk kemi identifikuar mangësi të tilla	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime konkrete që raportimi i shpenzimeve nga atashetë të jenë në kohën e duhur dhe që të gjitha avanset të mbyllen bazuar në shpenzimet e ndodhura duke i respektuar afatet sipas rregulloreve në fuqi.	Avancet e vitit 2021 ishin mbyllur, përderisa nuk kemi identifikuar raste të tilla për 2022.	I zbatuar
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri duhet të sigurojë rritjen e nivelit të mbikëqyrjes dhe menaxhimit të kontratave publike, duke aplikuar penalet në rastet kur ka mospërmbushje të kontratave apo konfiskim të sigurisë së ekzekutimit. Po ashtu, duhet siguruar një kordinim më efektiv në mes akterëve rreth implementimit të kontratave.	Gjatë auditimit për vitin 2022 kemi vërejtur se MM ka rritur nivelin e kontrollit të mbikëqyrjes së kontratave dhe nuk kemi identifikuar mangësi të tilla.	I zbatuar
6.	Pasuritë	Ministri duhet të siguroj se respektohen afatet e përcaktuara në lidhje me procesin e vlerësimit dhe tjetërsimit të pasurive në mënyrë që azhurnimi dhe harmonizimi i regjistrave kontabël të pasurive të kryhet para finalizimit të PFV –ve, duke reflektuar në vlerën e saktë të pasurive.	MM për vitin 2022 kishte marr vendim për formimin e komisioneve dhe kishte përfunduar procesin e inventarizimit, vlerësimit dhe tjetërsimit të pasurive me kohë.	I zbatuar

7.	Pasuritë	Ministri duhet të siguroj që zyrtari kryesor i pasurisë brenda MM-së organizon trajnime për personelin përgjegjës që merren me regjistrim të pasurive në sistem nëpër regjione dhe duhet t'i mbaj të azhurnuar me mënyrën se si duhet aplikuar sistemi e-Pasuria.	MM në bashkëpunim me ASHI kishte organizuar dhe mbajtur trajnim për pjestarët e FSK, ku janë çertifikuar 51 pjestarë dhe një zyrtar i MM.	I zbatuar
----	----------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Ariana Berisha Rexhëbeqaj, Udhëheqëse e ekipit



Adelina Selmani, Anëtare e ekipit



Flora Berisha, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Mbyllja e avansit pa pranim të plotë të shërbimeve të trajnimit	Nuk pajtohem me bazën e kualifikimit të raportit, pasi që mbyllja e avansit ka të bëjë me shërbim të trajnimeve për pjestarët e FSK-së të cilat ofrohen nga programi shtetëror FMS i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe se mbyllja nuk përbën asnjë rrezik në ofrimin e këtyre shërbimeve apo aspekteve financiare që nërlidhen me këto trajnime, pasi që ky trajnim ofrohet nga vetë SHBA-të.	Nga komenti i OB-së vërehet arsyetimi në lidhje me çështjen e sigurisë së pranimin të shërbimeve të trajnimit përderisa Raporti i Auditimit e ka trajtuar mospajtueshmërinë e mbylljes së avansit nga aspekti i rregullave ligjore.  Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.
Aplikimi i procedurës negociuar pa publikim dhe vonesë në liferimin e mallit	MM nuk pajtohet se procedura e negociuar për blerjen e kombi busëve nuk ka qenë në harmonime ligjin e prokurimit, pasi që një gjë e tillë e ka konfirmuar/aprovuar KRPP bazuar në kërkesën e arsyetuar të MM të datës 02.06.2022, si institucion kompetent për vlerësimin e ligjshmërisë së procedurave të negociuara. Nisur nga nevojat e mëdha të FSK për automjete transportuese si dhe konfirmimin e procedurës nga KRPP, e njëjta është zhvilluar konform legjislacionit në fuqi.	Në këtë gjetje është prezantuar njoftimi në KRPP për aplikimin e procedurës, mirëpo çështja e theksuar ka të bëjë me ndryshimin e procedurës për të njëjtin tender por duke i ndryshuar specifikat.  Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
Data: 07.06.2023			
Ordi. Nr. / Ord. No.	Titulli / Title	Nr. Prot. / Br. Prot.	Nr. Fletëve / Br. Stranica
03	47911	1	1



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government  
 Ministria e Mbrojtjes  
 Ministarstvo Odbrane Ministry of Defense

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MBROJTJES - MINISTARSTVO ODBRANE - MINISTRY OF DEFENSE			
Nr. Prot. / Br. Prot.	1849	Nr. Fletëve / Br. Stranica	1
Data / Datum / Date	07.06.2023		

<b>DATË/A:</b>	07.06.2023
<b>REFERENC-Ë:</b>	359/3/2023
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Zyrën Kombëtare të Auditimit Adresa: Lagjja Arbëria, Rr. Ahmet Krasniqi, 210 - Prishtinë
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	Armend MEHAJ, Ministër i Mbrojtjes, MM
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Avdyllkadër MUÇAJ, zv. Sekretar i Përgjithshëm të MM
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	<b>Letër e Konfirmimit</b> Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kemi pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Ministrit së Mbrojtjes**, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Nuk pajtohem me bazën e kualifikimit të raportit, pasi që mbyllja e avancit ka të bëjë me shërbime të trajnimeve për pjesëtarët e FSK-së të cilat ofrohen nga programi shtetëror FMS i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe se mbyllja nuk përbën asnjë rrezik në ofrimin e këtyre shërbimeve apo aspekteve financiare që ndërlidhen me këto trajnime, pasi që ky trajnim ofrohet nga vetë SHBA-të. MM nuk pajtohet se procedura e negociuar për blerjen e kombi bosëve nuk ka qenë në harmoni me ligjin e prokurimit, pasi që një gjë të tillë e ka konfirmuar/aprovuar KRPP bazuar në kërkesën e arsyetuar të MM të datës 02.06.2022, si institucion kompetent për vlerësimin e ligjshmërisë së procedurave të negociuara. Nisur nga nevojat e mëdha të FSK për automjete transportuese si dhe konfirmimin e procedurës nga KRPP, e njëjta është zhvilluar konform legjislacionit në fuqi.
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>7</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>8</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

### (shkëputur nga SNISA 200)

#### Forma e opinionit

##### **Opinion i pa-modifikuar**

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Në stok janë regjistruar me çmime tjera si, Gas mask (and Tactical respirator) 155.93 me një diferencë 0.47euro për njësi më pak në sistemin pasuria ( $0.47*560=263.20$ euro) dhe Kanister për gas maskë Filter 37.12euro, më shumë në sistemin e pasuria në vlerë prej 4.02 për njësi ( $560*4.02=2,251.20$ euro).
- <sup>6</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>7</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>8</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.